



**NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES**

**PRN186 Eminent – Prishtinë**

Ndërmarrja Shoqërore për Tregti Ndërkombëtare dhe Qarkullim të brendshëm DP''Eminent''- Pristina Fi.837.91; Drustveno Preduzece za Medjunarodnu Trgovinu i Unutrasinji Promet; ShA'' Eminent'' me Përgjegjësi të Plota në Pronësi të Përzier Fi 3425/94 DD ''Eminent''sa Potpuno Odgovornosc u Mesovitoj Svojini Fi 3425/94

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 26 shkurt 2020 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 23 dhjetor 2019.

**Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 6 mars 2020 dhe përfundon me datë 23 prill 2020 në orën 16:00.**

**Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje së kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.**

**Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.**

**Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Prishtinë**

**Rr. Rexhep Mala Nr. 2 (afër Ambasadës Sllovene),**

**10 000 Prishtinë,**

**Telefoni: +383 (38) 226 889**

**Fax: +383 (38) 227 100**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **''Formularët-Udhëzime për plotësim''**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.